

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **“DADA CLEANING” SH.P.K.**

Sot, ne Tirane, me date 17.06.2022, me cilesine e ortakut te vetem themelues te shoqerise:

- Znj Marisa Nito, atesia Filip, e datelindjes 23.07.1982, lindur dhe banuese ne Tirane madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me leternjoftimin ID me nr personal I25723059K


Ka vendosur themelimin e shoqerise **“Dada Cleaning” sh.p.k.**

Me nenshkrimin e ketij Akti Themelimi te nje shoqerie tregtare, nenshkruesi dhe themeluesi i saj merr persiper te realizoje e te respektoje te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga klauzolat e meposhtme, te cilat do te specifikohen gjeresisht ne Statutin e shoqerise:

### **THEMELIMI I SHOQERISE**

Ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" te ndryshuar, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar **“Dada Cleaning” sh.p.k** (me poshte ne kete akt e quajtur "Shoqeria") nga Ortaku i vetem themelues te saj.

### **FORMA E SHOQERISE**



Shoqeria **“Dada Cleaning” sh.p.k**, me poshte e referuar si “Shoqeria”, eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar krijuar ne baze te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare”, dhe rregullohet prej ketij ligji, dhe statutit te shoqerise si dhe prej cdo dispozite tjeter ligjore te aplikueshme.

## **II EMRI I SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA**

### **Neni 1**

#### **Emri**

Emri i shoqerise eshte **“Dada Cleaning ” sh.p.k**. Ne cdo dokument, fature, reklame dhe publikime emri i shoqerise do te pasohet nga:

- (i) fjala “me pergjegjesi te kufizuar” apo “sh.p.k”
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

### **Neni 2**

#### **Selia**

Selia administrative e shoqerise do te jete ne: Tirane, Rruga Zef Jubani pallati 6/1.

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise **“Dada Cleaning” sh.p.k** eshte **pa afat**. Ortaku i vetem ka te drejte te kufizojte kete afat duke zbatuar procedurat per ndryshimin e Statutit.

*Ortaku Auto.*

### **III OBJEKTI I SHOQERISE**

#### **Neni 4**

#### **Objekti**

Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin shqiptar do te jete:

- *Te zhvilloj aktivitet ne fushen e sherbime pastrimi profesionale ne objekte publike, sociale, private, ne fasada ndertesash, mirembajtje dhe pastrime te brendshme te te gjitha llojeve, mirembajtje hapësirash te gjelberta, sistemim, lavanderi. Administrim dhe pastrim ambjentesh. Tregti produktesh pastrimi. Shoqeria mund te ndermarre te gjitha operacionet tregtare, industrial dhe financiare te cilat I konsideronte nevojshme dhe te dobishme per arritjen e objektit te shoqerise,por gjithmone duke respektuar kufijte e vendosur nga legjislacioni ne fuqi. Shoqeria , per arritjen e objektit te aktivitetit tregtar, mund te marre me qira ose te menaxhoje shoqeri apo dege te shoqerive, te jape ose te marre perfaqesi si agjensi, per te kryer me ato komisione ne menyre direkte ose indirekte, perte fituar interesa ose pjesmarrje ne shoqeri te tjere qe kane objekte te ngjashme, te lidhura ose te ngjashme me objektin e aktivitetit tregtar te vet, te transaksionojë kredi, ose dhe hipoteka , te bleje apo shese pasuri te" paluajtshme, makineri dhe paisje, si dhe cdo veprim tjeter te nevojshem per menaxhimin e aktivitetit.*

Pervec veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari qe do te konsiderohet nga ortaku si e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise dhe qe nuk vjen ne kundërshtim me Ligjin Shqiptar.

### **IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI**


#### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njqind mije) leke.

Kapitali themeltar eshte i perbere nga 1 kuote me nje vlere nominale si me poshte:

**-MARISA NITO - 1 KUOTE ME VLERE 100.000 LEKE**



**OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:**

**MARISA NITO - 100 %**


**Neni 6**

**Organizimi**

Shoqeria do te drejtohet nga nje Administrator. Kete detyre do ta kryej per periudhen e pare prej **5 vjetesh**, i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise.

**ORTAKU I VETEM**

**ZNJ.MARISA NITO**

  
\_\_\_\_\_

